

MBROJTJA E PERSONALITETIT

Neni 32

- 1) Punëdhënësi respekton dhe mbron në raportet e punës personalitetin e punëmarrësit.
 - 2) Ai duhet të parandalojë çdo qëndrim që cenon dinjitetin e punëmarrësit.
 - 3) Punëdhënësi ndalohet të kryejë çdo veprim që përbën shqetësim seksual karshi punëmarrësit dhe nuk lejon kryerjen e veprimeve të tilla nga punëmarrësit e tjerë.
- Me shqetësim seksual kuptohet çdo shqetësim që dëmton në mënyrë të dukshme gjendjen psikologjike të punëmarrësit për shkak të seksit.

DETYRIMI

Neni 33

Punëdhënësi, gjatë marrëdhënieve të punës, nuk duhet të mbledhë informata lidhur me punëmarrësit, përveç rasteve, kur këto informata lidhen me aftësitë profesionale të punëmarrësve ose janë të nevojshme për zbatimin e kontratës.

KONTROLLI I SENDEVE VETJAKE

Neni 34

(Ndryshuar me ligjin nr.9125, datë 29.07.2003)

- 1) Punëmarrësi dhe sendet e tij vetjake nuk bëhen objekt i kontrollit, me përjashtim të rasteve kur duhet të mbrohet pasuria e punëdhënësit, punëmarrësve të personit juridik ose personave të tretë nga një cenim i paligjshëm.
 - 2) Kontrolli kryhet gjatë kohës së punës nga punëdhënësi ose një person i caktuar prej tij.
- Personi që kontrollon dhe personi që kontrollohet duhet të jenë të së njëjtës gjini.
- 3) Kontrolli kryhet brenda territorit të ndërmarrjes, në prani të një punëmarrësi tjetër, të pranuar nga punëmarrësi që kontrollohet.

CERTIFIKATA E PUNËS

Neni 35

- 1) Punëmarrësi i kërkon punëdhënësit në çdo kohë një certifikatë mbi natyrën dhe kohëzgjatjen e punës, cilësinë e saj dhe sjelljen e tij.
- 2) Me kërkesën e shprehur të punëmarrësit, certifikata përmban të dhëna vetëm mbi natyrën dhe kohëzgjatjen e marrëdhënieve të punës.
- 3) Punëdhënësi nuk ka të drejtë t'u japë të tretëve informacione për punëmarrësit e tij me përjashtim të rasteve të parashikuara në ligj ose me pëlqimin e punëmarrësit.

REGJISTRI

Neni 36

- 1) Punëdhënësi mban regjistrin e punëmarrësve të punësuar në ndërmarrje.
- 2) Përmbajtja e regjistrit caktohet nga dispozitat e këtij Kodi dhe me vendim të Këshillit të Ministrave.

MASA DISIPLINORE

Neni 37

(Ndryshuar me ligjin nr.9125, date 29.07.2003)

Masat disiplinore parashikohen kryesisht në kontratën kolektive të punës. Në çdo rast kontrata individuale duhet t'i referohet akteve përkatëse, lidhur me masat disiplinore.

VËNIA NË DISPOZICION E KODIT

Neni 38

Punëdhënësi duhet të vërë në dispozicion të punëmarrësve në çdo ndërmarrje një kopje të Kodit të Punës.